



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:076625

Datë: 23.05.2023

Numri i dokumentit: 04312783

PA1.nr.1687/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Kadrije Goga Lubishtani, kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Beqir kalludra, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e praktikantes gjyqësore Ardelina Sijarina, në çështjen penale ndaj të akuzuarit A. B. nga Gj., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë truporë nga neni 185 par. 3 nënpar. 3.1 lidhur me par. 1 nënpar.1.4 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.296/2022, datë 14.09.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 12.05.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

Me rastin e ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, e sipas detyrës zyrtare **anulohet** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.296/2022, datë 14.09.2022, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan me aktgjykimin P.nr.296/2022, datë 14.09.2022, të akuzuarin A. B. e ka shpallur fajtorë për shkak të veprës penale lëndim i lehtë truporë nga neni 185 par. 3 nënpar. 3.1 lidhur me par. 1 nënpar.1.4 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 120 ditëve ashtu që me propozim dhe pëlqim të akuzuarit dhe në kuptim të nenit 44 të KPRK të akuzuarit dënimi i shqiptuar i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej 1000 (njëmijë) euro. I akuzuari dënimin me gjobë obligohet ta paguaj në afat prej 3 (tre) muajve dhe atë pesë këste nga dita kur aktgjykimi të merre formën e prerë. Nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj gjobën atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që 1 ditë burgim do të llogaritet për çdo 20 euro të gjobës. Është obliguar i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 25 euro €, si dhe për programin e kompensimit e viktimave të krimit, shumën prej 30 (tridhjetë) €, të gjitha këto nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

E dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civilo juridik.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur :

Prokuroria Themelore në Gjilan, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarit ti shqiptoj dënim më të ashpër.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtrësën PPA/II.nr.1725/2022 të datës 17.11.2022 ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i lartë dhe dënim me burg efektiv.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatoj se :

- Me rastin e ankesës së Prokurorisë, sipas detyrës zyrtare **anulohet** aktgjykimi i ankimuar.

Prokuroria Themelore në Gjilan e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, duke pretenduar se dënimi i shqiptuar të akuzuarit nuk është dënim i merituar sipas ligjit sepse dënimi është zbutur tej mase dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore për zbutjen e dënimit. Rrethanat lehtësuese çfarëdo qofshin ato nuk kanë mundur të vlerësohen në atë masë që të pandehurit ti shqiptohet dënim me burg minimal, ku si rrethanë lehtësuese ka marrë vetëm pranimin e fajësisë ndërsa rrethanat rënduese gjykata nuk ka përmendur asnjë por vetëm ka konstatuar se duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës, edhe pse tek e dëmtuara ish-bashkëshortja e tij i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore. Duke mos i marrë parasysh rrethanat si mënyra e kryerjes së veprës penale, vepra është kryer ndaj viktimës së ndjeshme dhe pasojat janë të dukshme. Po të vlerësoheshin këto rrethana në mënyrën e duhur sigurisht se sanksioni penal do të ishte tjetër dhe më i ashpër.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit penal, megjithatë kolegji penal duke u bazuar në nenin 394 paragrafi 1 të KPPRK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe në këto drejtime dhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 pika 1.10 KPPRK, ngase aktgjykimin të ankimuar i mungon plotësisht arsyetimi lidhur me rrethanat të cilat janë marrë parasysh nga gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit, përkatësisht në arsyetimin e aktgjykimin nuk është përshkruar as edhe një rrethanë qoftë rënduese apo lehtësuese të cilat gjykata i ka marrë parasysh me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit por vetëm ka konstatuar se *“duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë dhe më harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë*

penale”, e që sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykata përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale ngase aktgjykimin të ankimuar i mungon plotësisht arsyetimi lidhur me rrethanat rënduese apo lehtësuese për caktimin e dënimit të cilat detyrimisht kanë shkaktuar anulimin e aktgjykimin të atakuar dhe kthimin e çështjes në rigjykim dhe rivendosje.

Nga të lartcekurat, Gjykata e Apelit, vlerëson se aktgjykimi i ankimuar juridikisht është i paqëndrueshëm dhe si i tillë është dashtë të anulohet dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim. Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet që të evitojë shkeljet e lartë cekura dhe me rastin e përpilimit të aktgjykimin ti përfshijë të gjitha rrethanat e rastit konkret të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit në atë mënyrë që të veprojnë në pajtim me dispozitat e KPRK lidhur me rrethanat që ndikojnë në shqiptimin e dënimit.

Ankesa e Prokurorisë themelore në Gjilan tani për tani është jolëndore.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 402 të KPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Departamenti i Përgjithshëm

PA1.nr.1687/22, më datë 12.05.2023

Procesmbajtëse:

Ardelina Sijarina

Anëtarët e kolegjit:

Skender Çoçaj

Kryetari i kolegjit:

Kadrije Goga Lubishtani

Beqir Kalludra
